



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 09.06.2025
Numër Protokoli: 3889/2025

A.nr.727/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.727/2025, të datës 24.04.2025, të parashtruar nga ankuesja Z.K, nga Prishtina, kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.727/2025, e datës 24.04.2025, e parashtruar nga ankuesja Z.K.

II. Shfuqizohet Njoftimi i datës 23.04.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore për shpalljen e kandidatëve fitues, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit me shifër: RN00016626 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Zbatimit të Projekteve”, i shpallur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, Z.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 24.03.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.727/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00016626 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Zbatimit të Projekteve”, i shpallur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 29.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajit, ndërsa kjo e fundit, me datë 13.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2724/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 24.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Njoftimin e datës 23.04.2025 për kandidatët e suksesshëm; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 13.05.2025; Konkursi e datës 05.02.2025; Vendimin e datës 07.04.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së me akt emërimet/kontratën përkatëse; Listën e aplikantëve; Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit të datës 22.04.2025; Formularin e renditjes përfundimtare i datës 22.04.2025; Aplikacionin e ankueses të datës 07.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit B.Sh të datës 06.02.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit L.B të datës 06.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit V.K të datës 06.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 05.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016626, për Grupi i Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Zbatimit të Projekteve”-Kategoria Specialist, në kuadër të Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.02.2025 deri më 07.03.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 9 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja.

Tutje, ankuesja i është nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa sipas Formularit të datës 22.04.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, rezulton se ankuesja dhe 3 kandidatë të tjerë e kanë kaluar pragun minimal prej 70 pikësh për tu vlerësuar si kandidatë të suksesshëm, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga nenin 11 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si në vijim: “Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i

Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat”, respektivisht ankuesja ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 84.6 pikë, (prej tyre 60.6 pikë në testin me shkrim, ndërsa 24 pikë në intervistë me gojë), kandidati V.K ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 88.2 pikë, (prej tyre 64.2 pikë në testin me shkrim, ndërsa 24 pikë në intervistë me gojë), kandidati L.B ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 89.8 pikë, (prej tyre 70 pikë në testin me shkrim, ndërsa 19.8 pikë në intervistë me gojë), si dhe kandidati B.Sh ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 90.02 pikë, (prej tyre 64.4 pikë në testin me shkrim, ndërsa 25.8 pikë në intervistë me gojë), prandaj thënë si më lartë, Njësia e Burimeve Njerëzore të Këshillit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 23.04.2025, ka publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, nga rezulton se kandidatët me më së shumti pikë rezulton të jenë B.Sh me gjithsejtë 90.20 dhe L.B me gjithsejtë 89.80 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Njoftimit të datës 23.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se procedura përkatëse e rekrutimit është përcjellë me shkelje të ligjit material dhe shkelje procedurale, ashtu që gjatë ditës së testimit me shkrim kandidatët e suksesshëm B.Sh dhe L.B kanë qenë të shoqëruar nga stafi i institucionit, kandidatët e suksesshëm kanë kërkuar informata lidhur me përpilimin apo hartimin e eses, testimin e kanë përfunduar në kohë shumë të shkurtë, e njëjta pretendon po ashtu se sallën e kam lëshuar 10 minuta para se të përfundojë testimi me shkrim, ndërsa pyetjet në kompjuterin kandidatit L.B kanë qenë të gjitha të paselektuara, ashtu që është e pamundur për një kohë prej 10 minutash të mbetur të përgjigjet apo plotësohet testi me shkrim nga kandidati respektiv, me kërkesën që ankesa e ankueses të aprovohet nga Këshilli, ndërsa procedura e rekrutimit të anulohet.

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë pretendimet e ngritura nga pala ankuese, analizoi Vendimin Nr.112-223 të datës 07.04.2025 përmes të cilit Sekretari i Përgjithshëm të MAPL-së, e ka themeluar Komisionin e Pranimit në përbërje prej pesë (5) anëtarësh, si në vijim: **1.** R.K- Kryesues, me zëvendësues Xh.M; **2.** S.B- anëtar, me zëvendësueses H.A; **3.** A.R-anëtar, me zëvendësueses A.J; **4.** B.P-anëtar, me zëvendësueses H.A; dhe **5.** B.P- anëtar, me zëvendësueses E.B, ndërsa duke marr për bazë Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit të datës 22.04.2025 në intervistë me gojë, vlerësimin e kandidatëve e kanë kryer anëtarët si në vijim: Kryesuesi R.H sipas aktit të emërimit të datës 17.04.2014, mban pozitë “Udhëheqës i Divizionit të Banimit”, Zëvendësues i anëtarit, H.A sipas kontratës së datës 15.07.2024 është i punësuar në UBT në pozitën “Staf Akademik”; Zëvendësuesja e anëtarit, A.J sipas aktit të emërimit të datës 03.01.2019 mban pozitën “Zyrtare e Lartë për Zhvillim dhe Monitorim të Zbatimit të Projekteve”, anëtarit B.P sipas aktit të emërimit të datës 03.01.2019 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Siguri, Standarde dhe Rregulla teknike në aktivitetet minerare” si dhe, anëtarit B.P sipas ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 16.12.2018 mban pozitën “Zyrtar i Lartë i Personelit”, dhe mbi këtë bazë konstatoi se Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, sikurse përcaktohet se: " *1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidatëve për pranim në shërbim civil në pozitën e specialistit, themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon*

procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit për kategorinë e specialistit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse për pozitën apo grupin e pozitave për të cilat zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) profesor i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi” ,ngase prej 5 anëtarëve sa ka komisioni, 3 (tre) prej tyre kërkohet të jenë nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, kurse në rrethanat e rastit konkret vetëm dy (2) anëtarë rezultojnë të jenë nga kjo kategori.

Kolegji i Këshillit, po ashtu me datë 29.04.2025 në kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të MAPL-së, ka kërkuar edhe, citoj si në vijim: *“Testet me shkrim, për ankuesen dhe kandidatët e suksesshëm”*, kurse Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MAPL-së përmes shkresës së datës 05.05.2025 në përgjigje në ankesën e ankuesit me provat e dërguara kishte deklaruar se lidhur me kërkesën për sigurimin e testeve me shkrim (nuk kemi qasje), kurse Kolegji me datë 03.06.2025 e kishte sugjeruar këtë të fundit që për një çështje të tillë t’i drejtohet Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me qëllim të sigurimit të testeve me shkrim, kurse Njësia e Burimeve Njerëzore e MAPL-së, me datë 03.06.2025 e konfirmon kërkesën dhe deklarojnë se ju kemi drejtuar DMZP-së me kërkesë të na ofrojnë testet, mirëpo Këshilli deri me datë 04.06.2025 nuk kishte pranuar provat e kërkuara me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike, respektivisht analizimit të vlerësimit të testit me shkrim/Eses nga anëtarët e komisionit për kandidatët e suksesshëm.

Kolegji i Këshillit më qëllim të konstatimit të gjendjes faktike analizoi Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit të datës 22.04.2025 në intervistimin me gojë, dhe konstatoi se kryesuesi i Komisionit të Pranimit R.H, me rastin e vlerësimit të kandidatit të suksesshëm L.B tek vlerësimi i pyetjes me numër 2, fillimisht e kishte vlerësuar kandidatin me dy (2) pikë, ndërsa më pastaj e ka ndryshuar vlerësimin duke e vlerësuar me tre (3) pikë, po ashtu njëjtë kishte vepruar edhe në vlerësimin e pyetjes së pestë (5), ashtu që fillimisht e kishte vlerësuar kandidatin me dy (2) pikë, ndër më pastaj e ka ndryshuar vlerësimin duke e vlerësuar me tre (3) pikë, e për rrjedhojë ka ndodhur edhe ndryshimi tek totali i pikëve nga 23, është bërë 24 pikë, mirëpo ajo që bije në sy, zyrtari në fjalë në formularin përkatës të datës 22.04.2025 nuk ka dhënë asnjë koment apo vërejtje, ndërsa një rast i ngjashëm ka ndodhur edhe tek rasti i vlerësimit ankueses, ashtu që anëtarja e komisionit A.J te pyetja me numrin rendor katër (4), fillimisht e kishte vlerësuar ankuesen me tre (3) pikë, ndërsa më pastaj e ka ndryshuar vlerësimin duke e vlerësuar me katër (4) pikë, mirëpo në këtë rast është dhënë komenti në formular.

Prandaj, nga konstatimet e dhëna si më lartë Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *“7.1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe*

konkurruese”, si dhe nenit 21 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, konstatoi se procedura e pranimit RN00016626 për Grupi i Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Zbatimit të Projekteve”, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material, respektivisht nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 21 paragrafi 2 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me kërkesat dhe parakushtet ligjore, sikurse anëtarët e komisionit, në dy raste kanë ndryshuar pikët e vlerësimit sipas konstatimit të gjendjes faktike, bazuar në Formularët e vlerësimit individual të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit të datës 22.04.2025 në intervistën me gojë, sikurse u pasqyrua edhe me lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se meqenëse konstatoi të gjeturat e theksuara si më lartë, nuk u lëshuar në shqyrtimin e mëtejme të kësaj çështje administrative, pasi që një fakt i tillë, pra konstatimit nëse pretendimet e tjera të ankuesit janë të qëndrueshme apo jo, sikurse nëse ka apo jo edhe shkelje të tjera procedurale apo materiale, nuk do ta ndryshonte natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, pasi që janë konstatuar shkelje esenciale të parimeve të pranimit në shërbimin civil, andaj ankesa e ankueses u aprovua vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në këtë vendim.

Thënë si më lartë, dhe mbi bazën e të gjeturave nga provat e administruara në këtë shqyrtim administrativ Kolegji i këshillit në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme*”, konstatoi se Njoftimi i datës 23.04.2025 për kandidatët e suksesshëm është i paligjshëm, ndërsa me qëllim të kthimit të ligjshmërisë duke marr për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 55 paragrafi 1 të LPPA-së, vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi në tërësi procedurën e rekrutimit me shifër RN00016626 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrje të Zbatimit të Projekteve”, ndërsa ankesën e ankueses e aprovoi si të bazuar vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.727/2025, datë 09/06/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesja Z.K;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (Sekretarit të Përgjithshëm, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.